

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Lufthanza Teknik AG nga Gjermania do të fitojë kontroll të pavarur mbi LG-LHT Eirkraft Solushns GmbH, Gjermani, LG-LHT Pesinxher Solushns GmbH, Gjermani dhe AerKju GmbH, Gjermani**

**(lënda nr. 08-86 /2024)**

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 20.05.2024, në Komisionin për mbrojtjen e konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Lufthanza Teknik AG me seli në Veg Bajm Jeager 193, 22335, Hamburg, Gjermani do të fitojë kontroll të pavarur mbi subjektet e mëposhtme:

- LG-LHT Eirkraft Solushns GmbH me seli të regjistruar në rr. Hindenburg 162, 22297 Hamburg, Gjermani,
- LG-LHT Pesinxher Solushns GmbH me seli të regjistruar në rr. Hindenburg 162, 22297 Hamburg, Gjermani, dhe
- AerKju GmbH me seli të regjistruar në rr. Hindenburg 162, 22297 Hamburg, Gjermani.

Aktualisht, shoqëritë e synuara kontrollohen bashkërisht nga LHT dhe LG Elektroniks Inc. (Transaksioni i propozuar do të çojë në një ndryshim kontrolli (d.m.th. kontrolli i përbashkët i LHT së bashku me LGE do të ndryshojë në kontroll të pavarur nga LHT) dhe do të rrisë pjesën partnere të LHT-së në Shoqëritë e synuara.

LHT është një kompani globale e regjistruar në Gjermani, me seli në Hamburg dhe pjesë e Grupit Lufthanza. LHT është një ofrues global i shërbimeve të mirëmbajtjes, riparimit dhe riparimit për avionët, motorët dhe komponentët, si dhe zhvillimin, projektimin dhe furnizimin e sistemeve të menaxhimit të kabinës dhe argëtimit gjatë fluturimit. Ai përbëhet nga 30 fabrika që ofrojnë shërbime teknike të aviacionit për klientët në mbarë botën, duke përfshirë prodhuesit e pajisjeve origjinale, kompanitë e dhënies me lizing të avionëve, operatorët (B)VIP të avionëve, qeveritë dhe forcat e armatosura, si dhe linjat ajrore.

Grupi Lufthanza nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut.

Shoqëritë e synuara janë aktive në fushën e SUK dhe SZL vetëm për avionë komercialë, veçanërisht në projektimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe shitjen e softuerit dhe harduerit për kabinat e avionëve, pajisjet elektronike, si dhe sistemet e ndriçimit, sensorët, kamerën dhe ekranin (*display*) për avionët komercialë. Shoqëritë e synuara nuk janë të angazhuara me SUK dhe SZL për aeroplanë biznesi, VIP ose qeveritarë.

Kompanitë e synuara nuk kanë asnjë aktivitet në Maqedoninë e Veriut.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të*

*dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

23.05. 2024

Shkup